



REPUBLIKA E MAQEDONIS SË VERIUT
REPUBLIKA E MAQEDONISË SË VERIUT



Në bazë të nenit 22 paragrafi 1 dhe nenit 23 paragrafi 1 të Ligjit për parandalimin e korrupsionit dhe konfliktit të interesave ("Gazeta zyrtare e Republikës së Maqedonisë" Nr. 12/2019) neni 36 paragrafi 1 dhe neni 40 dhe 41 të Rregullores së punës së Komisionit Shtetëror për Parandalimin e Korrupsionit, KSHPK duke vepruar në bazë të denoncimit nga parashtrues i njohur, në vazhdimin e seancës së 51-të, të mbajtur më datë 01.09.2021 morri,

VENDIM

Denoncimi për korrupsion nr. 12-2525/1 / 1, datë 21.07.2021 nga parashtrues i njohur- -----, REFUZOHET.

Në përputhje me dispozitat e Ligjit për Parandalimin e Korrupsionit dhe Konfliktit të Interesave, Komisioni Shtetëror për Parandalimin e Korrupsionit nuk ka elemente për veprimin e tij të mëtejshëm kompetent, për arsye se tashmë ka vepruar organ tjetër në lëndën me numër 12-2525/1 të datës 21.07.2021.

Lënda me numër 12 -2525 e vitit 2021 të mbyllet dhe të arkivohet.

Vendimi i Komisionit Shtetëror për Parandalimin e Korrupsionit, me arsyetim - në formë të depersonalizuar, të publikohet në ueb - faqen e internetit të Komisionit Shtetëror brenda 5 (pesë) ditëve nga miratimi i tij.

Kopje nga vendimi të dorëzohet deri te parashtruesi i denoncimit.

Arsyetim

Lënda me numër 12-2525/1 e vitit 2021 e formuar në bazë të denoncimit me nr. 12-2525/1 të datës 21.07.2021 nga parashtrues i njohur----- .

Në denoncim theksohet se denoncuesi në ngjarjen që ka ndodhur në vitin 2017 pranë teleferikut në Vodno, për të cilën, siç thuhet në denoncim, ndodhi një "krim", ai pësoi lëndime të rënda trupore.

Parashtruesi iu drejtua Ministrisë së Punëve të Brendshme, dhe më pas me parashtruesat e duhura në Prokurorinë Publike Themelore dhe Zyrën e Lartë të Prokurorit Publik, dhe paraqiti të gjithë dokumentacionin bashkangjitur kërkesës.

Nga bashkëngjitjet e paraqitura në denoncim, përcaktohet se organet e përmendura tashmë kanë vepruar pas ngjarjes në fjalë.

Bazuar në të gjitha rrethanat dhe të dhënat e përfshira në denoncimin e lëndës, Komisioni Shtetëror për Parandalimin e Korrupsionit, nga aspekti i kompetencave të Komisionit Shtetëror për Parandalimin e Korrupsionit në denoncimin e lëndës përcaktoi se nuk ka elemente të veprimit kompetent, gjegjësisht tashmë ka vepruar organ tjetër kompetent sipas të njëjtave pohime.

Për arsye, siç u tha më lart, Komisioni Shtetëror vlerësoi se denoncimi nuk përmban elemente për veprime kompetente të Komisionit Shtetëror në përputhje me nenin 17 të Ligjit për Parandalimin e Korrupsionit dhe Konfliktit të Interesit.

Duke pasur parasysh të theksuarën e mësipërme, Komisioni Shtetëror për Parandalimin e Korrupsionit vendosi si në dispozitën e këtij vendimi.

KOMISIONI SHTETËRO
PËR PARANDALIMIN E
KORRUPSIONIT
Kryetar,
Biljana Ivanovska

Dorëzuar deri te:
Arkivi
Parashtruesi

Përgatiti: M.r K.Z, Këshilltar
Miratoi: M.r .SH.S, Anëtar i KSHPK-së

